

STATUTI I SHOQERISE

PLENTY Sh.p.k

Sipas ligjit N.9901, te dates 14.04.2008 "Per Tregtaret dhe shoqerite tregtare", ligji n.9723 te dates 03.05.2007 "Per Qendren Kombetare te Biznesit" eshte themeluar shoqeria si vijon:

DISPOZITAT E PERGJITHSHME

NENI 1. Eshte themeluar nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar (Sh.p.k.) e emertuar **PLENTY** Shpk, me ortake :

1. Z. ROLAND JARANI, lindur me 07/09/1972, ne Tirane, banues ne Tirane, me ID Nr. 034037782, zoterues i 50% te kuotave te kapitalit te shoqerise
2. Z. KEVIN JARANI, lindur me 13/02/2001, ne Tirane, banues ne Tirane, me ID nr. 033550321, zoterues i 50% te kuotave te kapitalit te shoqerise.

SELIA

NENI 2. : Tirane, Njesia Administrative Kashar, Yzberisht, Rr. Eqerem Cabej, 03920094, Ndertesa Nr.5, Njesi sherbimi, Kati 1.

Shoqeria mund të krijojë apo te perfshije seli sekondare, te krijojë dege, filiale dhe zyra brenda dhe jashte kufijve te territorit shqiptar.

KOHEZGJATJA

NENI 3. Kohëzgjatja e shoqërisë është caktuar në 99 (nëntëdhjetë e nëntë) vjet.

Shoqeria mund te shtyje afatin ne baze te normave ligjore.

OBJEKTI

Shitje te produkteve kozmetike; Shitje te detergjenteve; Import dhe eksport te produkteve te ndryshme. Shitje e cigareve, duhanit dhe tabakove. Shitje e produkteve dhe mallrave ushqimore dhe industrial. Pavaresisht sa me siper, Shoqeria mund te kryeje çdo aktivitet te nevojshem apo te dobishem te lejuar nga ligji per realizimin e objektit te saj te veprimtarise.

KAPITALI THEMELTAR

NENI 5. Kapitali themeltar eshte 100.000,00 lekë i ndare ne 2 kuota te ndare si me poshte:

1. Z. Roland Jarani, 1 kuote me vlere totale 50.000 leke
2. Z. Kevin Jarani 1 kuote me vlere totale 50.000 leke.

Kapitali do te derdhet teresisht me aktin e themelimit. Asambleja mund te marre vendim per rritje te kapitalit, duke percaktuar afatin, kushtet dhe modalitetet. Kapitali mund te shtohet nepermjet akordimit te pasurive ne natyre apo kredite.

Ne interesin financiar te shoqerise ortaku mund te kryeje derdhje pa interes ne llogari kapitale, si edhe financime me apo pa interes, duke respektuar me perpikmeri ligjin.

Shoqeria mund te procedoje me rimbursime te financimit qofte te pjesshme apo totale; mbledhjen e fondeve nga ortaket, me te drejte rimbursimi, duhet tu drejtohet ekskluzivisht subjekteve qe jane ne perputhje me kerkesat e ligjit dhe rregulloreve, sipas rregullave te autoriteteve perkatese.

ASAMBLEJA

NENI 6. Asambleja thirret ne rastet dhe menytrat e parashikuar nga ligji ne seline e shoqerise apo ne cdo lloj vendi tjeter, me lajmerim apo thirrje edhe ne Shqiperi, sipas zgjedhjes se Organit Administrativ.

Asambleja mund te thirret gjithashtu edhe nepermjet postes elektronike, me dergimin e lajmerimit te pakten tete dite para caktimit te mbledhjes, ne adrese te postes elektronike duke informuar shoqerine dhe i shenuar ne librin e Ortakeve.

Sipas pikes 83.2 te ligjit 9901,dt 14.04.2008 per Tregetaret dhe shoqerite tregtare, ne mungese te thirrjeve te rregullta jane gjithashtu te vlefshme asamblete ne te cilat jane te pranishem te gjithe ortaket e shoqerise.

Ortaku njoftues nepermjet nje prokure te posacme mund te paraqitet ne asamble nga nje person tjeter, sipas kerkesave te percaktuara nga ligji.

NENI 7. Asamblete e zakonshme do te marrin vendime sipas kompetences dhe me shumice te percaktuar nga ligji. Vendimet e marra te adoptuara ligjerisht detyrojne te gjithe ortaket per zbatim, persa kohe nuk nderhyjne apo kundershtojne.

NENI 8. Asambleja e zakonshme duhet te thirret te pakten nje here ne vit brenda gjashte muajve nga mbyllja e vitit ushtrimor.

Asambleja e zakonshme thirret sa here te jete e nevojshme nga organi administrativ dhe ne te gjitha rastet e parashikuara nga ligji.

NENI 9. Asamblete drejtohen nga administratori i vetem ose, kur eshte krijuar, nga Keshilli Administrativ, nga vete Presidenti i Keshillit ose, ne mungese te ketyre nga Administratori Delegates. Ne mungesen e tyre ,asambleja do te drejtohet nga personi qe do te paracaktohet nga asambleja.

Presidenti, i shoqeruar nga nje sekretar, ortak apo jo, i percaktuar nga asambleja ,duhet te konstatoje sipas parashikimit rreth pjesmarjes ne mbledhje.

ORGANI ADMINISTRATIV

NENI 10. Administrimi i shoqerise i eshte besuar nje Administratori te Vetem i emeruar per nje periudhe 5 vjecare dhe mund te rizgjidhet dhe revokohet ne perputhje me ligjin.



Administratori i vetëm është **Z. Kevin Jarani**.

NENI 11. Administratorit i takon rimbursimi i shpenzimeve të zyrës. Përcaktimi i kompensimit të administratorit përcaktohet nga asamblëja, kur kërkohej.

NENI 12. Sapo emerohet, Këshilli Administrativ, thirrjet nepermjet postës rekomandë, apo nepermjet telefaksit, telegramit, postës elektronike sa herë që Presidenti apo një nga administratorët ta gjykojnë të nevojshme, apo nëse kërkohej nga të paktën gjysma e administratorëve në ngarkim. Thirrja duhet dërguar të paktën pesë ditë para datës së përcaktuar të mbledhjes, në rezidencën e këshilltarëve apo të kryetarëve ose në studion profesionale ku të lartpërmendurit ushtrojnë aktivitetin e tyre apo në telefaksin, ose në adresën e postës elektronike të cilën posedon shoqëria.

Në rast urgjence thirrje mund të bëhet dhe nepermjet telegramit, telefaksit, apo postës elektronike të dërguara të paktën një ditë para datës së vendosur të mbledhjes.

Për vlefshmerinë e mbledhjes është e nevojshme praninë e shumicës së administratorëve.

Mbledhjet mund të zhvillohen dhe jashtë selisë së shoqërisë.

Lejohet mundësia që mbledhjet e Këshillit Administrues të mbahen nepermjet telekonferencave apo videokonferencave me kusht që të gjithë të pranishmit mund të jenë të identifikuar, qoftë dhe praninë e tyre për të ndjekur bisedën, të nderhyjnë në kohe reale në trajtimin e argumentave që po trajtohen, të marrin, të transemitojnë dhe të shohin dokumentat. Në rast të një supozimi të tillë, këshilli do të mbahet në vendin në të cilin ndodhet Presidenti dhe ku duhet të ndodhet gjithashtu Sekretari i mbledhjes, për të lejuar shkrimin dhe nënshkrimin e verbalit.

Në votim marrin pjesë pothuajse të gjithë të pranishmit, në rast barazie mbizoteron vota e Presidentit.

NENI 13. Nëse nominohet, Këshilli Administrues, kur është i pranishëm, kryesohet nga Presidenti dhe në rast mungese nga një Administrator i deleguar, apo nga Administratori më i vjetër në moshe.

Presidenti asistohet nga një Sekretar i emëruar nga vete Këshilli dhe jashtë përberësve të Këshillit.

NENI 14. Administratori i Vetëm, ose Këshilli i Administrimit nëse nominohet, marrin pushtete administrative që do të përcaktohen nga asamblëja në aktin e emërimit.

NENI 15. Përfaqësimi ligjor i Shoqërisë me përdorimin e firmës së shoqërisë përkundërt të tretëve i takon Administratorit të vetëm ose, në rastin kur shoqëria drejtohet nga një Këshill, Presidentit saj dhe administratorëve të deleguar deri në limitet që u janë deleguar, në mënyrë të pavarur ndërmjet tyre. Ata kanë mundësinë, administratorët e deleguar gjithmone në limitet e delegimit që u është dhënë, të promovojnë veprime dhe raste gjyqësore e administrative për çdo lloj shkalle juridiksioni, duke emëruar për këto qëllim avokatët.

Administratori Unik dhe/apo Keshilli i Administrates nese nominohet, kane te drejten te emerjone drejtore, po ashtu specialiste te akteve te percaktuara ose kategori aktesh,duke percaktuar kompensimet e tyre. Specialistet do te qendrojne ne krye te detyres deri ne plotesimin e detyres, nese nuk revokohet.

BORDI I SHOQERISE

NENI 16.Nese Asambleja e vendos dhe,ne cdo rast ,dhe sipas dispozitave te detyrueshme e ligjore,kontrolli dhe ruajtja e shoqerise do t'i besohet Bordit drejtues,te perbere nga tre anetare efektive dhe dy suplementare, sipas kerkesave konform ligjit.

Anetaret e Bordit emerohen per 3 vite ushtrimore dhe ata mund te rizgjidhen.

Shperblimi i bordit percaktohet nga asambleja per kohen e plote te mandatit dhe gjithsesi nuk mund te jete me i vogel se ai i percaktuar nga detyrimet tarifore profesionale.

BILANCI DHE TE ARDHURAT

NENI 17. Viti ushtrimor mbyllet me 31 dhjetor te cdo viti.
Organi Administrativ kujdeset, ne perputhje me kohen dhe normat ligjore, per redaktimin e bilancit.

SHPËRBËRJA DHE LIKUIDIMI

NENI 18. Per cdo lloj rasti apo shkaqe shperberje te parakoshme te shoqerise, normat per likuidim, emerimi i likuiduesve me fuqite perkatese, do te percaktohen nga asambleja ne perputhje me normat ligjore.

VENDBANIMI I ORTAKEVE

NENI 19.Vendbanimi i ortakut, per marrëdhëniet me shoqerine mendohet te mendohet i percaktuar ne adresen qe rezulton ne librin e ortakeve.

RREGULLA PERFUNDIMTARE

NENI 20.Per c'ka nuk eshte shprehur ne Statutin aktual, i duhet referuar dispozitave te Kodit Civil dhe ligjeve lidhur me to.

Tirane, me 07/11/2023

PLENTY Sh.p.k

ORTAKET

ROLAND JARANI

ROLAND JARANI



KEVIN JARANI

KEVIN JARANI

